

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 55672/22
Radovan Çela
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 20 janar mars 2026, si Dhomë e përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar*,
Lətif Hüseyinov,
Darian Pavli,
Úna Ní Raifeartaigh,
Mateja Đurović,
Canòlic Mingorance Cairat,

Vasilka Sancin, *gjyqtarë*,

dhe Milan Blaško, *kancelar i Seksionit*,

Duke pasur parasysh kërkesën më sipër të depozituar më 29 nëntor 2022,

Duke pasur parasysh parashtrimet e depozituara nga Qeveria e paditur dhe prapësimet e paraqitura nga kërkuesi,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTET

1. Kërkuesi, z. Radovan Çela, është shtetas shqiptar i lindur në vitin 1981 dhe banues në Tiranë. Ai u përfaqësua në Gjykatë nga z. I. Shehu, avokat me licencë në Tiranë.

2. Qeveria e Shqipërisë ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti i saj në atë kohë, z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

Rrethanat e çështjes

3. Faktet e çështjes, siç u parashtruan nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë.

4. Kërkuesi është avokat në Shqipëri.

5. Fillimisht në Belgjikë filloi hetimi për disa persona, përfshirë kërkuesin mbi dyshimin që ata kishin kryer në bashkëpunim veprat penale të pastrimit të parave, falsifikimit të dokumenteve dhe përdorimit të dokumenteve të falsifikuara. Në kuadër të atij hetimi, më 30 mars 2020, Gjykata e Shkallës së Parë e Brukselit kërkoi që autoritetet shqiptare të këqyrnin të dhënat e celularit dhe korrespondencës së postës elektronike të kërkuesit, të kontrollonin banesën dhe zyrën e tij dhe të sekuestronin çdo dokument ose send të rëndësishëm për hetimin, përfshirë telefona celularë dhe kompjuterë. Gjithashtu, kërkoi që autoritetet "të kryejnë një kontroll digjital të vendndodhjeve të rëndësishme me kopje teknike dhe ligjore të bëra dhe të certifikuara për saktësinë e tyre". Autoritetet belge kërkuan kopje të të gjitha mesazheve elektronike të dërguara dhe të marra nga adresa elektronike e kërkuesit që nga 1 majit 2018 dhe një procesverbal të të gjitha thirrjeve dhe mesazheve hyrëse dhe dalëse nga telefoni celular i kërkuesit ndërmjet datës 1 maj 2018 dhe 30 mars 2020.

6. Në atë kohë, kërkuesi, gjithashtu, përfaqësonte interesat e disa të dyshuarve të tjerë në procese të lidhura penale në Shqipëri. Kërkuesi nuk ishte as i dyshuar as i akuzuar në ato procese.

7. Më 27 prill 2020, Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë pranoi kërkesën dhe ia përcolli Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (Prokuroria e Posaçme").

8. Më 5 maj 2020, prokuroria e posaçme paraqiti kërkesën në Gjykatën e Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit dhe më 18 maj 2020 dhe më 22 nëntor 2021, pasi mori dokumente të tjera nga autoritetet belge, gjykata e shkallës së parë bazuar në nenin 506 të Kodit të Procedurës Penale, e pranoi kërkesën në një seancë të mbajtur vetëm me praninë e prokurorisë.

9. Policia gjyqësore dhe një hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit kontrolluan banesën dhe zyrën e kërkuarit më 8 shkurt 2022. Në zyrën e kërkuarit, u kontrollua kompjuteri dhe celulari i tij dhe policia e sekuestroi kompjuterin dhe kopjoi dokumente të ndryshme në lidhje me klientët e tij. Në banesën e kërkuarit nuk u sekuestrua asnjë objekt dhe nuk u kopjuan apo u shkarkuan dokumente.

10. Sipas procesverbalit të kontrollit të banesës dhe zyrës ai nuk kishte kundërshtuar dhe as nuk ishte ankuar për ligjshmërinë e kontrollit. Kërkuari e firmosi procesverbalin.

11. Më 7 qershor 2022, kërkuari depozitoi një ankim kushtetues kundër vendimeve të 18 majit 2020 dhe më 22 nëntorit 2021 dhe kundër kontrollit të banesës dhe zyrës së tij. Ai pretendoi *inter alia* që vendimet e kundërshtuara nuk përmbanin arsye të mjaftueshme dhe që kontrolli i banesës dhe zyrës së tij dhe këqyrja e përmbajtjes së celularit dhe *email*-eve të tij ishin bërë në shkelje të mbrojtjes së posaçme që kanë avokatët, siç parashikohet në nenin 52 të Kodit të Procedurës Penale. Ai, gjithashtu, pretendoi se kontrolli përbënte shkelje të paprekshmërisë së banesës së tij, e cila, si një vend privat, gëzonte mbrojtje të posaçme sipas Konventës dhe Kushtetutës. Gjithashtu, garancitë procedurale ishin në dispozicion të tij si avokat, siç e parashikon ligji për profesionin e avokatit, neni 52 i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 8 i Konventës. Ndërhyrja në të drejtat e tij nuk ishte në përputhje me ligjin. Më tej kërkuari u ankua që ai nuk kishte pasur mundësi ankimi kundër vendimeve të kundërshtuara dhe për kushtet në të cilat ishte bërë kontrolli i banesës dhe zyrës së tij. Ai, gjithashtu, kundërshtoi kushtetutshmërinë e nenit 506 të Kodit të Procedurës Penale.

12. Ankimi kushtetues i kërkuarit u shpall i papranueshëm më 14 korrik 2022 për mosshkrimin e mjeteve juridike të mëparshme. Gjykata Kushtetuese gjeti që procesi kushtetues në thelb kishte të bënte me proceset penale në Belgjikë, që gjykata e shkallës së parë kishte pranuar kërkesën e autoriteteve belge, duke iu referuar neneve 506 dhe 507 të Kodit të Procedurës Penale dhe që autoritetet shqiptare thjesht ishin vënë në lëvizje për atë kërkesë. Ligji i zbatueshëm ishte ligji belg, që është jashtë juridiksionit të Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese u shpreh që ankimet e kërkuarit duhej të vlerësoheshin nga pozita e tij si viktimë e shkeljeve të dyshuara në kontekstin e ekzekutimit të letërporosisë në Shqipëri. Gjykata Kushtetuese doli në përfundimin që, në lidhje me kontrollet e kryera në Shqipëri, kërkuari kishte në dispozicion mjetet juridike të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Vendimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të konsiderohej i formës së prerë sipas kuptimit të nenit 131, paragrafi 1, shkronja f i Kushtetutës.

13. Më 7 shkurt 2024, në Shqipëri filloi një hetim i ndarë në lidhje me kërkuarin mbi dyshimin e kryerjes së veprave penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm mbi persona që ushtrojnë funksione publike në pesë raste të ndryshme dhe për dhënie ryshfeti gjyqtarëve dhe prokurorëve në dy raste të ndryshme. Këto procese janë akoma duke u zhvilluar.

KUADRI LIGJOR PÛRKATËS DHE PRAKTIKA

A. Kushtetuta

14. Pjesët përkatëse të Kushtetutës lexojnë si më poshtë:

“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 36

“Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara.”

Neni 37

“1. Paprekshmëria e banesës është e garantuar.

2. Kontrollat e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj.

3. Askujt nuk mund t’i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjанuar një rrezik që i kanoset sigurimit publik.”

Neni 43

“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.”

Neni 131

“1. Gjykata Kushtetuese vendos, për:

...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.”

B. Kodi i Procedurës Penale

15. Dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (ligji nr. 7905 i 21 marsit 1995, i ndryshuar), lexojnë si më poshtë:

Neni 52

Garancitë për mbrojtësin

(ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, neni 38)

“1. Këqyrjet dhe kontrollimet në zyrën e mbrojtësit lejohen vetëm:

a) kur ai ose persona të tjerë që zhvillojnë vazhdimisht veprimtari në të njëjtën zyrë janë të pandehur dhe vetëm brenda qëllimeve për të provuar veprën penale që u atribuohet;

b) për të zbuluar gjurmët ose provat materiale të veprës penale ose për të kërkuar sende a persona të përcaktuar në mënyrë të posaçme;

c) në rastet kur mbrojtësi ndodhet në *kushtet e flagrancës* ose të ndjekjes, sipas paragrafit 1, të nenit 298, të këtij Kodi.

2. Para se të bëjë këqyrjen, kontrollimin ose sekuestrimin në zyrën e një mbrojtësi, organi procedues njofton këshillin drejtues të dhomës së avokatëve, me qëllim që një anëtar i tij të ketë mundësinë që të jetë i pranishëm në veprimet. Përveç rasteve të *flagrancës*, organi procedues shtyn këqyrjen, kontrollimin ose sekuestrimin deri në mbërritjen e anëtarit të caktuar, por jo më shumë se dy orë pasi është informuar Dhoma e Avokatisë. Në çdo rast një kopje e aktit i dërgohet këshillit drejtues të dhomës së avokatëve.

3. Këqyrjet, kontrollimet dhe sekuestrimet në zyrat e mbrojtësve, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të paragrafit 1, të këtij neni, i bën gjyqtari personalisht, kurse gjatë hetimeve paraprake ato i bën prokurori në bazë të një vendimi autorizues të gjykatës.

4. Nuk lejohet përgjimi i bisedimeve ose i komunikimit të mbrojtësve dhe të asistentëve të tyre, as ndërmjet njëri-tjetrit dhe as me personat që ata mbrojnë.

5. Ndalohet çdo formë kontrolli e korrespondencës ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

6. Rezultatet e këqyrjeve, të kontrollimeve, të sekuestrimeve, të përgjimeve të bisedave ose të komunikimit, të kryera në shkelje të dispozitave të mësipërme, nuk mund të përdoren.

SEKSIONI II KONTROLLET

Neni 202

Kushtet për kryerjen e kontrolleve (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, neni 105)

“1. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale gjykata merr vendim për kontrollin personal. Kur këto sende ndodhen në një vend të caktuar, vendoset kontrolli i vendit ose banesës.

2. Gjikata që ka nxjerrë vendimin mund të veprojë vetë ose të urdhërojë që veprimi të kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore, të caktuar në vendimin e kontrollit.

3. Në rast *flagrance* ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur, që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontroll, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298.”

Neni 202/a

Vendimi për lejimin e kontrollit (shtuar me ligjin nr. 35/2017, neni 106)

“1. Vendimi për lejimin e kontrollit duhet të tregojë llojin e kontrollit, personin që kontrollohet dhe gjeneralitetet e tij, vendin apo banesën objekt kontrolli, provat materiale apo sendet që kërkohen, arsyet që lejojnë kontrollin, si edhe autoritetin që do të kryejë atë.

2. Kur ka arsye të bazuara se të dhënat, informacionet, programet informatike ose gjurmë të tyre, gjenden në një sistem informatik ose telematik, edhe kur ky është i mbrojtur me masa sigurie, gjykata merr vendim për kontrollin, duke urdhëruar masa teknike të përshtatshme, të cilat sigurojnë ruajtjen e të dhënave origjinale dhe nuk lejojnë ndryshimin e tyre. Vendimi i kontrollit duhet të përcaktojë llojin e informacionit që kërkohet dhe mënyrën e marrjes së tij.

3. Gjikata merr vendim të arsyetuar në dhomë këshillimi, brenda 24 orëve nga kërkesa e prokurorit. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për kontroll mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit brenda 24 orëve. Gjikata e apelit shqyrton ankimin brenda 48 orëve nga marrja e akteve.

4. Kontrolli duhet të përfundojë brenda 72 orëve nga momenti i marrjes së vendimit për kryerjen e tij.”

Neni 205

Kontrolli i vendeve (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, neni 109)

“1. Të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe atij që ka në dispozicion vendin u dorëzohet kopja e vendimit të kontrollit, duke e njohur me të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar, i cili ndodhet aty dhe është i përshtatshëm, sipas nenit 108, të këtij Kodi, ose mbrojtësit të tij.

2. Kur i pandehuri kërkon praninë e mbrojtësit gjatë kryerjes së kontrollit, organi procedues shtyn kryerjen e kontrollit deri në mbërritjen e mbrojtësit, por jo më shumë se 2 orë nga momenti që mbrojtësi ka marrë dijeni për kontrollin. Gjatë kësaj kohe, organi procedues mund të kufizojë lëvizjen e personit të interesuar dhe personave të tjerë që ndodhen në vendin që do të kontrollohet.

...”

Neni 206

Koha për kryerjen e kontrollit të banesës

“1. Kontrolli në një banesë ose në një vend të mbyllur ngjitur me të nuk mund të fillojë para orës shtatë dhe pas orës njëzet. Në raste të ngutshme organi procedues mund të urdhërojë me shkrim që kontrolli të bëhet tej këtyre caqeve.”

Neni 207

Sekuestrimi gjatë kontrollit (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, neni 110)

“1. Sendet e gjetura gjatë kontrollit sekuestrohen, me kusht që të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit.

2. Sende të tjera të gjetura gjatë kontrollit, që nuk përfshihen në vendimin përkatës, por që lidhen me të njëjtën vepër penale, mund të sekuestrohen duke respektuar dispozitat për sekuestrimet.

3. Kur gjatë kontrollit zbulohen sende që nuk kanë lidhje me veprën penale për të cilat është dhënë vendimi i kontrollit, por që lidhen me një vepër tjetër penale që ndiqet kryesisht, sendet e zbuluara sekuestrohen.

4. Për sekuestrimet e kryera në kushtet e paragrafëve 2 dhe 3, të këtij neni, zbatohen kriteret e nenit 301 të këtij Kodi.”

Neni 212

Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit

“1. I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë në kërkimit të tyre, mund të bëjë ankim në gjykatë, e cila merr vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve.

2. Kundër vendimit të gjykatës lejohet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata e apelit jep vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve nga marrja e akteve.

3. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit.”

Neni 301

Vleftësimi i sekuestros

(ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, neni 163)

“1. Kur vë sekuestron *in situ*, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja.

2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë, të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t’i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros.”

Neni 407

Rastet dhe mjetet e ankimit

“1. Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit.

2. Ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit.

...

4. E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. Kur ankimi bëhet në gjykatën jokompetente, ajo ia dërgon aktet gjykatës kompetente. ...”

KREU II

LETËRPOROSITË NDËRKOMBËTARE

SEKSIONI I

LETËRPOROSITË NGA JASHTË SHTETIT

Neni 505

Kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë

“1. Ministria e Drejtësisë *vendos që t’i jepet rrugë* letërporosisë së një autoriteti të huaj për komunikimet, njoftimet dhe për marrjen e provave, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesa të rëndësishëm të shtetit.

2. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë, kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë edhe kur ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e procesit, si dhe kur nuk del që i pandehuri të ketë shprehur lirisht pëlqimin e tij për letërporosinë.

3. Në rastet kur letërporosia ka si objekt thirrjen e një dëshmitari, të një eksperti a të një të pandehuri para autoritetit gjyqësor të huaj, Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë letërporosisë, kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur për papekshmërinë e personit të thirrur.

4. Ministria ka të drejtë të mos i japë rrugë letërporosisë kur shteti kërkes nuk jep garancinë e duhur të reciprocitetit.”

Neni 506

Procedimi gjyqësor

(ndryshuar me ligjin nr. 99/2014)

“1. Letërporosia e huaj nuk mund të vihet në ekzekutim pa u marrë më parë vendimi në favor i gjykatës së vendit ku duhet të procedohet.

2. Prokurori i rrethit, pasi merr aktet nga Ministria e Drejtësisë, paraqet kërkesën në gjykatë brenda 5 ditëve nga paraqitja e akteve nga Ministria e Drejtësisë.

3. Gjykata disponon ekzekutimin e letërporosisë me vendim brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

4. Ekzekutimi i letërporosisë nuk pranohet:

a) kur janë rastet që Ministria e Drejtësisë *nuk i jep rrugë* letërporosisë, në përputhje edhe me parashikimet e akteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe rezervat e deklarimet ligjore;

b) kur fakti për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale.”

Neni 507

Ekzekutimi i letërporosive

(ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, neni 281)

“1. Gjykata që pranon kërkesën për ekzekutimin e letërporosisë, kryen dhe veprimin e kërkuar ose autorizon për këtë qëllim prokurorin, në rastet kur ligji e lejon.

2. Për kryerjen e veprimeve të kërkuara zbatohen normat e këtij Kodi, përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkuara nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar.”

C. Ligji nr. 8510 i 15 korrikut 1999 për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore

16. Neni 1 dhe 3 i ligjit (ndryshuar me ligjin nr. 10005 të 23 tetorit 2008) parashikon që Shteti është përgjegjës për dëmin pasuror dhe jopasuror jashtë kontraktor, që u shkaktohet personave fizikë a juridikë, privatë, vendës a të huaj. Institucionet shtetërore kanë detyrimin të japin dëmshpërblim, *inter alia* kur, përmes ushtrimit të funksioneve të tyre publike, veprimet ose mosveprimet e tyre të ligjshme dëmtojnë interesat e ligjshëm të personave fizikë ose juridikë.

17. Ligji nr. 8510 përkufizon administratë shtetërore si më poshtë: a) zyra e Kryeministrit; b) ministritë; c) institucionet e varësisë nën Kryeministrin ose ministrat; d) njësitë e ofrimit të drejtpërdrejtë të shërbimit; e) agjencitë e pavarura; dhe f) prefekturat administrative.

D. Praktika e gjykatave të brendshme

1. Gjykata e Lartë

18. Në vendimin unifikues nr. 61002-00692-00-2021 të 23 dhjetorit 2021 Gjykata e Lartë shprehet, si më poshtë:

“38. Sipas këtyre parashikimeve, personi i interesuar, i cili nuk lidhet domosdoshmërisht vetëm me personin ndaj të cilit zhvillohen hetimet, mund të paraqesë ankim ndaj vendosjes së kësaj mase të sekuestros. Nga interpretimi literal i kësaj dispozite, pra i nenit 212 të KPP-së, Kolegji çmon të evidentojë se, referuar terminologjisë së përdorur nga ligjvënësi, duhet që vendimi i gjykatës ose i prokurorit, për sekuestrimin e sendeve, të jetë ekzekutuar. ... Pra, kundërshtimi në gjykatë i vendimit të sekuestrimit, nuk mund të bëhet nëse nuk është ekzekutuar sekuestroja.”

19. Në vendimin nr. 00-2023-762 të 28 marsit 2023 Gjykata e Lartë shprehet, si më poshtë:

“26. Ligji taksativisht i ka njohur të drejtën e ankimit prokurorit ndaj vendimit të gjykatës që nuk lejon kontrollin, që do të thotë se ndaj vendimit për pranimin e saj, indirekt ka shmangur të drejtën për të ushtruar ankim ndaj vendimit të kontrollit, për palët e tjera. Pra, konkluzioni që, ka arritur gjykata e apelit se, ky vendim është i pa kontestueshëm është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

27. Për sa i përket vendimit për ushtrimin e kontrollit, ligji nuk ia ka njohur të drejtën e ankimit palës ndaj së cilës ushtrohet kontrolli ose vihet në dijeni, se ndaj saj është marrë një vendim i tillë. Pretendimet në lidhje me vendimin e kontrollit, pala e interesuar ka mundësi që t'i paraqesë në fazën e vlerësimit të sekuestrimit si një fazë shqyrtimi "post facto" ..."

20. Në vendimin e saj nr. 60001-00512-00-2024 të 17 dhjetorit 2024, Gjykata e Lartë u shpreh që të gjitha pyetjet e faktit duhet të shqyrtohen nga gjykata më të ulëta. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në vendimin e saj nr. 159 të 16 prillit 2004 – cituar në vendimin e Gjykatës së Lartë për një ankim sipas nenit 212 të Kodit të Procedurës Penale – tregon që Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit iu referua nenit 8 të Konventës në vlerësimin e saj të vleftësimit të urdhrit të kontrollit.

2. Gjykata Kushtetuese

21. Në vendimin e saj nr. 265 të 12 dhjetorit 2023, në lidhje me mundësinë e ankimit kundër një vendimi që urdhëron kontrollin e banesës së një personi dhe të personit, Gjykata Kushtetuese u shpreh që ky ankim nuk lejohej sipas Kodit të Procedurës Penale.

Pjesa përkatëse e atij vendimi lexon si më poshtë:

"19. Gjykata Kushtetuese konstaton se GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, duke interpretuar nenet 202 e vijues, 407 dhe 420 të KPP-së, kanë vlerësuar se ligji nuk parashikon të drejtën e ankimit ndaj vendimit të kontrollit, ndaj vendimi i kontrollit është i paankimueshëm.

Sipas Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 207, pika 4, të KPP-së, kur kontrolli rezulton me sekuestrim të provave materiale, vendimi i sekuestrimit është i ankimueshëm dhe i interesuari ka mundësi t'i paraqesë në aktin e ankimit të vendimit të sekuestrimit, pretendimet eventuale për procedurën e kontrollit.

...

20. Gjykata Kushtetuese evidenton se KPP-ja ka parashikuar në mënyrë të shprehur se kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për kontroll mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatë brenda 24 orëve, ndërsa për vendimin që e lejon kontrollin nuk ka parashikuar të drejtën e ankimit.

Në këtë kuptim, është i arsyeshëm interpretimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm se kur ligji nuk parashikon shprehimisht të drejtën e ankimit, afatet dhe/apo subjektet të cilat mund ta ushtrojnë atë, atëherë vendimi është i paankimueshëm.

Kjo do të thotë se kufizimi i së drejtës së ankimit të kërkuarve në një gjykatë më të lartë është rrjedhojë e interpretimit të ligjit, për të cilin në jurisprudencë konstante kushtetuese është pohuar se i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme (shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 9, datë 26.3.2018; nr. 7, datë 7.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese).

21. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se, siç është shprehur Gjykata e Lartë, kur organi procedues nga kontrolli personal dhe i vendeve sekuestron prova materiale, atëherë pretendimet për procedurën e kontrollit paraqiten nga i interesuari në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë. Duke vijuar këtë analizë, rezulton se në rastin kur nga kontrolli nuk gjenden sende për t'u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe se të interesuarit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t'i paraqesë pretendimet kushtetuese në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual. Ky i fundit, pas reformës kushtetuese të vitit 2016, që ka zgjeruar juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore, përbën mjetin efektiv në dispozicion të individit sipas nenit 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut..., duke garantuar në këtë mënyrë aksesin dhe ankimin substancial në gjykatë."

22. Në vendimin nr. 21 të 22 prillit 2025 Gjykata Kushtetuese shprehet si më poshtë:

"28. Për sa u përket vendimeve të ndërmjetme për kontrollet, Gjykata Kushtetuese vëren se Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon të drejtën e ankimit ndaj tyre, por vetëm ndaj vendimeve të sekuestrimit të provave materiale gjatë kontrolleve (nenet 202–212, 407 dhe 420 të Kodit të Procedurës Penale). Gjykata Kushtetuese çmon se ligjvënësi duhet të vlerësojë nëse duhet plotësuar legjislacioni procedural penal për t'i ofruar individit mjetet juridike efektive për kundërshtimin përpara gjykatave të zakonshme të masës së kontrollit të vendeve ose atij personal edhe në rastin kur kontrolli nuk shoqërohet me masën e sekuestrimit, për sa kohë që kontrolli mbart në vetvete mundësinë për të cenuar të drejtat dhe liritë themelore. Megjithatë, duke iu referuar parashikimeve aktuale ligjore, Gjykata vë në dukje se kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë ankimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashikohen nga individit në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual. Nëse nga kontrolli nuk gjenden sende për t'u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe individit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t'i paraqesë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit drejtpërdrejt në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual."

23. Në vendimin nr. 42 të 1 korrikut 2025 Gjykata Kushtetuese shprehet, si më poshtë:

“22. Në lidhje me këtë kriter të legjitimitit, për sa u përket pretendimeve të kërkuases për cenimin e paprekshmërisë së banesës, për shkak të kontrollit të pretenduar të zyrës, Gjykata mban në konsideratë edhe qëndrimin e saj për kontrollin kushtetues të pretendimeve për cenimin e të drejtave substanciale, për shkak të kontrollit personal ose të vendeve. Sipas këtij qëndrimi, referuar parashikimeve aktuale ligjore, kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrihen nga individit në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual.

Po kështu, për sa kohë që kriteri i shterimit të mjeteve juridike kërkon edhe që të gjitha pretendimet që ngrihen në këtë Gjykatë të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë (shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese), Gjykata ndalet edhe në verifikimin e pretendimeve të kërkuases në këtë aspekt.

...

74. Së fundi, Gjykata Kushtetuese vëren se Kodi i Procedurës Penale nuk ka ndonjë parashikim për mundësinë e ankimit të një mase kontrolli të vendit apo të banesës, qoftë të lejuar me vendim të gjykatës, ashtu edhe të kryer me iniciativë nga prokuroria. Megjithatë, në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese është shprehur se referuar parashikimeve aktuale ligjore, kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrihen nga individit në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual (shih paragrafin 22 të vendimit). Kurse kur nga kontrolli nuk gjenden sende për t'u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe individit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t'i paraqesë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit drejtpërdrejt në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual (shih vendimin nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese).

ANKIMET

24. Kërkuesi u ankua sipas nenit 8 të Konventës për kontrollin e banesës dhe të zyrës së tij dhe sekuestrimin e provave materiale gjatë kontrollit të zyrës së tij.

25. Më tej ai u ankua sipas nenit 13 të Konventës që nuk kishte mjete juridike për ankimet e tij sipas nenit 8.

LEGJISLACIONI

26. Kërkuesi u ankua që vendimi për lejimin e kontrollit të banesës dhe zyrës së tij, përfshirë edhe korrespondencën e tij, mënyra se si ishte kryer kontrolli i banesës dhe zyrës së tij dhe sekuestrimi i provave materiale, përbënte shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 8 të Konventës. Më tej ai u ankua që nuk kishte mjete juridike efektive në dispozicion për ankimet e tij, ndryshe nga neni 13. Neni 8 dhe 13 i Konventës, në pjesën e rëndësishme, lexojnë si më poshtë:

Neni 8

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

Neni 13

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

A. Shterimi i mjeteve juridike të brendshme

1. Parashtrimet e palëve

a) Qeveria

27. Qeveria pranoi që kontrolli i banesës dhe zyrës së kërkuarit nuk ishte kryer sipas një urdhër kontrolli të zakonshëm, por sipas një vendimi të marrë në lidhje me një letërporosi nga autoritetet belge. Megjithatë, pavarësisht kësaj kontrolli ishte kryer në bazë të një vendimi gjykate dhe duhej të plotësonte kërkesat e Kodit të Procedurës Penale.

28. Qeveria parashtroi se para depozitimit të një ankimi kushtetues, kërkuesi kishte pasur disa mjete juridike në dispozicionin e tij që ai nuk i kishte përdorur.

29. Qeveria theksoi se sipas neni 507 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, të gjitha masat e miratuara nga gjykatat shqiptare dhe të zbatuara në përgjigje të letërporosive nga autoritetet e huaja duhej të respektonin dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Qeveria shpjegoi se kërkesat procedurale në lidhje me kontrollin rregulloheshin sipas neni 202 deri në 207 të Kodit të Procedurës Penale (shihni paragrafin 15 më sipër). Neni 52 i Kodit të Procedurës Penale përcakton garanci të tjera procedurale në lidhje me kontrollin e zyrës së avokatit.

30. Sipas qeverisë, kjo do të thotë që kur kontrolli sipas një letërporosie nuk është bërë në përputhje me dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Penale, është i mundur ankimi në gjykatë kundër vetë kontrollit. Qeveria pretendoi se ankimi kundër vendimit të shkallës së parë në përgjithësi përbënte një mjet efektiv të zakonshëm që duhej ndjekur për qëllime shteruese. Prandaj, çdo pretendim në lidhje me ligjshmërinë e kontrollit mund të ngrihet si pjesë e një ankimi të zakonshëm kundër vendimit përfundimtar për themelin, siç e parashikon neni 407 i Kodit të Procedurës Penale.

31. Nëse gjatë kontrollit sekuestrohen sende, ankimi i ndërmjetëm mund të depozitohet kundër sekuestrimit sipas neni 212 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale.

32. Më tej, sipas neni 151 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale, është e mundur që të kundërshtohet pranueshmëria e provave materiale të mbledhura gjatë një kontrolli dhe të kërkohej përjashtimi i tyre në çdo fazë të procesit.

33. Në lidhje me pretendimin për kompensimin e dëmit kundër shtetit sipas ligjit nr. 8510, Qeveria argumentoi se ky pretendim mund të bëhej në situata ku “administrata vepron ose jo në shkelje të ligjit, duke shkelur kështu të drejtat ose interesat e personave apo bizneseve.” Megjithatë, përgjegjësia e autoriteteve administrative ishte njohur edhe në çështje ku veprimet ose mosveprimet e tyre ishin gjetur të ligjshme në kushte formale, por ku rezultonin në dëm të interesave legjitimë të personave privatë.

b) Kërkuesi

34. Kërkuesi pretendoi se kontrolli i banesës dhe zyrës së tij nuk ishte lejuar nga gjykatat e brendshme, por ishte kryer bazuar vetëm në një letërporosi nga jashtë, e cila nuk mund të ankimohej.

35. Ai parashtroi se në përputhje me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, ankimi sipas Kodit të Procedurës Penale ishte i mundur vetëm kur ishte parashikuar shprehimisht në ligj. Kodi i Procedurës Penale nuk parashikonte të drejtën e ankimit kundër vendimeve që lejonin kryerjen e kontrollit për qëllim të marrjes së provave materiale. Kërkuesi pretendoi se vendimi mbi të cilin ishte kryer kontrolli i banesës dhe zyrës së tij nuk ishte urdhër kontrolli, por një vendim i dhënë sipas një letërporosie nga autoritetet belge. Ai theksoi se ky vendim ishte dhënë sipas neneve 506 dhe 507 të Kodit të Procedurës Penale, që rregullonte procedurën në lidhje me letërporositë nga jashtë. Gjithashtu, këto dispozita nuk parashikonin të drejtën e ankimit kundër vendimeve që pranonin këto letërporosi.

36. Më tej, kërkuesi pretendoi që mjeti juridik sipas neni 151 të Kodit të Procedurës Penale mund të përdorej në lidhje me provat materiale të pretenduara të papranueshme në kontekstin e procedimit penal në Shqipëri. Megjithatë, ky nuk ishte rasti sepse, në atë kohë, në Shqipëri nuk po zhvillohej asnjë procedim penal kundër tij dhe kontrollin në fjalë nuk ishin kryer në lidhje me ndonjë procedim penal në Shqipëri.

37. Në lidhje me pretendimin për kompensim, dëmi kundër Shtetit sipas ligjit nr. 8510 kërkuesi pretendoi se ai ligj parashikonte vetëm përgjegjësinë e institucioneve administrative shtetërore, përkatësisht Kryeministria, ministritë, institucionet e varësisë nën kryeministrinë ose ministritë, njësi e ofrimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve, agjencitë e pavarura dhe prefekturat.

38. Prandaj, dëmi i pretenduar i pësuar si pasojë e vendimeve të marra nga gjykatat e brendshme nuk mund të jetë objekt i pretendimit sipas atij ligji.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

39. Gjykata përsërit se detyrimi për të shteruar mjetet juridike të brendshme kërkon që kërkuesi të përdorë normalisht mjetet juridike që janë në dispozicion dhe të mjaftueshme, në lidhje me ankimet e tij/saj sipas Konventës. Ekzistenca e mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, pa të cilën ato nuk do të kenë aksesueshmërinë dhe efektivitetin e kërkuar (shihni *Vučković dhe të tjerë kundër Serbisë* (kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, § 71, 25 mars 2014, dhe *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) kundër Zvicrës* [DHM], nr. 21881/20, § 139, 27 nëntor 2023). Që një mjet juridik të jetë efektiv, ai duhet të rregullojë drejtpërdrejt gjendjen e kundërshtuar dhe duhet të ofrojë mundësi të arsyeshme suksesi (shihni *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS)*, § 139, cituar më sipër, me referenca të mëtejshme).

40. Megjithatë nuk është me detyrim përdorimi i mjeteve juridike që janë jo të duhura ose jo efektive (shihni *Vučković dhe të tjerë*, cituar më sipër, § 73, dhe *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS)*, cituar më sipër, § 141). Pyetja nëse një procedurë e brendshme përbën një mjet juridik efektiv sipas kuptimit të nenit 35 paragrafi 1 të Konventës, të cilin kërkuesi duhet ta shterojë varet nga disa faktorë, sidomos ankimi i kërkuarit, objekti i detyrimeve të Shtetit, sipas asaj dispozite të veçantë të Konventës, mjetet juridike në dispozicion në Shtetin e paditur dhe rrethanat specifike të çështjes (shihni, mes vendimeve të tjera, *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë* [DHM], nr. 56080/13, § 134, 19 dhjetor 2017, dhe *Ražnatović kundër Malit të Zi*, nr. 14742/18, § 27, 2 shtator 2021). Kjo do të thotë që një kërkuar nuk i kërkohet të depozitojë ankime tek organet ose institucionet që nuk kanë kompetencë apo fuqi për të ofruar zgjidhje efektive për ankimin në fjalë sipas Konventës (shihni *mutatis mutandis*, *Mukhametov dhe të tjerë kundër Rusisë*, nr. 53404/18 dhe 3 të tjerë, § 27, 14 dhjetor 2021).

41. Megjithatë Gjykata ka theksuar vazhdimisht nevojën për të zbatuar rregullin e shterimit me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalitet të tepruar. Gjithashtu, ka rënë dakord që rregulli për shterimin e mjeteve juridike të brendshme nuk mund të zbatohet në mënyrë automatike; gjatë shqyrtimit nëse është zbatuar, mbetet thelbësore që të mbahen parasysh rrethanat e veçanta të çdo rasti (shihni *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS)*, cituar më lart, § 140, me referenca të mëtejshme).

42. Në lidhje me barrën e provës, i takon Qeverisë që pretendon mosshterimin që të bindë Gjykatën se mjeti juridik i ofruar ishte efektiv, në dispozicion në teori dhe në praktikë në momentin e duhur. Pasi të jetë përmbushur kjo barrë, i takon kërkuarit që të përcaktojë që mjeti juridik në fakt është shteruar ose që për disa arsye nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe efektiv në rrethana të caktuara të çështjes, ose që kanë ekzistuar rrethana të veçanta që e përjashtojnë atë nga kjo kërkesë (shihni, mes shumë vendimeve të tjera, *Vučković dhe të tjerë*, § 77, dhe *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS)*, § 143, të dy të cituar më sipër).

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

43. Kërkuesi u ankua që vendimi që urdhëronte kontrollin e banesës dhe zyrës së tij mbulonte korrespondencën me klientët, përfshirë thirrjet dhe mesazhet e tij telefonike dhe të gjitha mesazhet në postën elektronike. Më tej ai u ankua që kontrolli i zyrës së tij ishte kryer në shkelje të nenit 52 të Kodit të Procedurës Penale.

44. Prandaj Gjykata duhet të vlerësojë nëse kërkuesi ka pasur një mjet efektiv në lidhje me ato ankime specifike.

45. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që në përputhje me praktikën e saj të konsoliduar, mjeti efektiv i kërkuar nga neni 13 i Konventës është i tillë ku autoriteti i brendshëm që shqyrton çështjen duhet të vlerësojë thelbin e ankimit sipas Konventës. Në rastet që kanë të bëjnë me

nenin 8 të Konventës, kjo do të thotë që autoriteti duhet të kryejë një ushtrim balancues dhe të shqyrtojë nëse ndërhyrja në të drejtat e kërkuarve i është përgjigjur një nevojë sociale të ngutshme dhe ka qenë proporcionale me qëllimet legjitime të ndjekura, pra, nëse përbën një kufizim të justifikuar të të drejtave të tyre (shihni *Voynov kundër Rosisë*, nr. 39747/10, § 42, 3 korrik 2018, dhe *C.G. dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, nr. 1365/07, § 62, 24 prill 2008, me referenca të mëtejshme).

46. Gjithashtu, Gjykata thekson se pasi të jetë kryer kontrolli ose pasi personi në fjalë të jetë vënë në dijeni për ekzistencën e një urdhri, duhet të ekzistojë një procedurë sipas së cilës ai ose ajo të mund të kundërshtojë shkaqet ligjore dhe faktike për urdhrin dhe të marrë zgjidhje nëse kontrolli është urdhëruar apo kryer në mënyrë të paligjshme (shihni *Reznik kundër Ukrainës*, nr. 31175/14, § 81, 23 janar 2025, referuar *Iliya Stefanov kundër Bullgarisë*, nr. 65755/01, § 59, 22 maj 2008, dhe *Avanesyan kundër Rosisë*, nr. 41152/06, § 29, 18 shtator 2014).

47. Gjykata Kushtetuese e shpalli të papranueshëm ankimin kushtetues të kërkuarve për mosshkrimin e mjeteve juridike, sipas Kodit të Procedurës Penale, pa specifikuar tamam mjetet juridike, të cilat nuk ishin provuar (krahasoni *Zubal' kundër Sllovakisë*, nr. 44065/06, § 33, 9 nëntor 2010). Megjithatë, kjo nuk mund të pengonte kërkuarve që të përdorte mjete të tjera juridike që mund të kenë qenë në dispozicion (krahasoni *Haščák kundër Sllovakisë* (vend.), nr. 13284/22 dhe 12127/23, § 53, 24 shtator 2024).

i. Në lidhje me mundësinë e depozitimit të një kërkesë për kompensim dëmi kundër Shtetit

48. Së pari, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkesa për kompensim dëmi sipas ligjit nr. 8510 mund të konsiderohet si mjet juridik efektiv në lidhje me ankimet e kërkuarve. Ajo vëren se ligji vetë përkufizon institucionet e administratës shtetërore të cilave iu referohet (shihni paragrafin 17 më sipër). Kjo nuk mbulon vendimet gjyqësore të gjykatave të brendshme, të vëna në pah nga kërkuari. Sidoqoftë, nuk është e dukshme që në çështjen e kërkuarve, gjykatat civile apo administrative do të ishin në gjendje të rishikonin arsyet pas vendimit për urdhërimin e kontrollit apo të vlerësonin ligjshmërinë ose justifikimin e sjelljes së punonjësve të policisë gjatë një operacioni kontrolli të kryer në kontekstin e proceseve penale në Belgjikë (krahasoni *Reznik*, cituar më lart § 88).

49. Prandaj Gjykata vëren se në këtë çështje, ka shumë pak gjasa që një kërkesë për kompensim, sipas ligjit nr. 8510 të mund të ketë ndonjë mundësi suksesi. Gjithashtu, Qeveria nuk parashtroi shembuj të jurisprudentës së brendshme përkatëse në mbështetje të pretendimeve të saj.

50. Situata mund të kishte qenë ndryshe, nëse Gjykata Kushtetuese do të kishte gjetur shkelje të të drejtave të kërkuarve, sipas nenit 8 të Konventës. Në ato rrethana, kërkuari do të kishte mundësinë të kërkonte kompensim për dëmin bazuar mbi këtë gjetje të Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

51. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se, duke iu referuar jurisprudentës së konsoliduar dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme me atë të kërkuarve, Qeveria nuk ka treguar që kërkesa për kompensim dëmi kundër Shtetit, sipas ligjit nr. 8510, ofronte të paktën disa mundësi për sukses, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë (krahasoni *Kilyen kundër Rumanisë*, nr. 44817/04, § 27, 25 shkurt 2014).

ii. Në lidhje me mundësinë e kundërshtimit të provave materiale të mbledhura gjatë kontrolleve

52. Gjykata vëren që në momentin që u kryen kontrollet objekt kundërshtimi në Shqipëri nuk kishte proces penal në pritje kundër kërkuarve dhe që kontrollet u kryen bazuar në një letërporosi të autoriteteve belge për qëllim të hetimit penal në lidhje me kërkuarve në Belgjikë. Gjithashtu, kërkuari nuk u ankua për përdorimin e provave materiale të mbledhura. Mjetet juridike sipas nenit 151 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale të referuara nga Qeveria synonin kundërshtimin e provave materiale të mbledhura gjatë kontrollit dhe prandaj nuk ishin me vend për rrethanat e kësaj çështjeje. E njëjta logjikë zbatohet për pretendimin e Qeverisë

që ligjshmëria e kontrollit mund të ishte kundërshtuar si pjesë e ankimit kundër vendimit përfundimtar për themelin e çështjes (shihni paragrafin 30 më sipër). Sidoqoftë, dyshohet që këto kundërshtime ose ankime do të kishin qenë në gjendje të ofronin kompensim të mjaftueshëm për ankimet e kërkuarit, sipas nenit 8 të Konventës, sepse ato kanë tendencë të përqendrohen në pranueshmërinë e çdo prove të mbledhur gjatë kontrollit, dhe jo domosdoshmërisht në ligjshmërinë ose përputhshmërinë e kontrollit me Konventën (krahasoni *P.G. dhe J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44787/98, § 86, GJEDNJ 2001 IX; *Goranova-Karaeneva kundër Bullgarisë*, nr. 12739/05, § 59, 8 mars 2011; *İrfan Güzel kundër Turqisë*, nr. 35285/08, §§ 106-07, 7 shkurt 2017; dhe *Särgava kundër Estonisë*, nr. 698/19, § 70, 16 nëntor 2021).

iii. Në lidhje me mundësinë e depozitimit të një ankimi të ndërmjetëm kundër kontrollit

53. Gjykata vëren se ankimi i kërkuarit për kontrollin e korrespondencës së tij me klientët lidhet me vendimin për urdhërimin e kontrollit.

54. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese tregon qartë se nuk është i mundur asnjë ankim i posaçëm kundër një vendimi që urdhëron kontrollin, si të tillë, të personave dhe ambienteve me qëllim marrjen e provave materiale (shihni paragrafin 19 më sipër).

55. Nga ana tjetër, nëse gjatë kontrollit është sekuestruar ndonjë send, mjeti juridik në dispozicion të kërkuarit është ai sipas nenit 212 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se çdo person i interesuar mund të depozitojë ankim në këtë situatë.

α) Kontrolli i banesës së kërkuarit

56. Gjykata vëren se neni 212 i Kodit të Procedurës Penale parashikon të drejtën e ankimit,, vetëm nëse gjatë kontrollit janë sekuestruar sende. Prandaj ankimi nuk mund të depozitohet kundër urdhrave të kontrollit ose kontrolleve, gjatë të cilave nuk është sekuestruar asnjë send, siç ndodhi me kontrollin në banesën e kërkuarit. Asnjë dispozitë tjetër e Kodit të Procedurës Penale nuk e parashikon mundësinë e depozitimit të një ankimi kundër një urdhër kontrolli apo kontrollit të banesave ku nuk sekuestrohen sende. Në fakt, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë e kanë pranuar shprehimisht që në këtë situatë nuk është parashikuar e drejta e ankimit.

57. Është e qartë nga praktika e gjykatave të brendshme që i vetmi mjet juridik që mund të adresonte ankimet në lidhje me kontrollin e banesës së kërkuarit do të kishte qenë një ankim kushtetues (shihni paragrafët 21–23 më sipër). Megjithatë, në çështjen e kërkuarit, Gjykata Kushtetuese nuk u angazhua në vlerësimin e themelit të ankimeve të tij. Nisur nga rrethanat e kësaj çështjeje, nuk mund të argumentohet që ankimi kushtetues i depozituar nga kërkuari ishte një mjet juridik efektiv për ankimet e tij sipas nenit 8 të Konventës.

58. Nisur nga konsideratat e mësipërme, kundërshtimi i Qeverisë për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme – sidomos në lidhje me ankimin për kontrollin e banesës së kërkuarit – duhet të rrëzohet.

59. Megjithatë, ky konkluzion nuk vë në diskutim efektivitetin e mjetit juridik si të tillë, apo detyrimin për të depozituar një ankim kushtetues për të shteruar mjetet juridike të brendshme në lidhje me ankimet për kontrollet e banesës së kërkuarve (krahasoni *Kaić dhe të tjerë kundër Kroacisë*, nr. 22014/04, § 43, 17 korrik 2008).

β) Kontrolli i zyrës së kërkuarit

60. Gjykata vëren se, sipas praktikës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, pasi sendet sekuestrohen gjatë një kontrolli, një palë e interesuar mund të paraqesë një ankim në një gjykatë më të lartë ku mund të ngrihen pyetje në lidhje me ligjshmërinë e urdhrit të kontrollit, mënyrën se si është kryer kontrolli dhe mënyrën se si janë sekuestruar sendet. Këto procese, në fund të fundit, mund të çojnë edhe në paraqitjen e një ankimi kushtetues dhe për këtë arsye mund të adresojnë ankimet në lidhje me justifikimin e urdhrit të kontrollit, ligjshmërinë e veprimeve të punonjësve të policisë (duke përfshirë edhe në lidhje

me privilegjin avokat klient) dhe sekuestrimin e provave materiale (krahasoni *Reznik*, § 87, cituar më sipër).

61. Fakti që kontrolli në fjalë u bazua në një vendim gjykate të dhënë në përputhje me një letërporosi nga autoritetet belge nuk do të thotë që kontrolli nuk duhej të ishte në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, siç parashikohet në nenin 507 § 2 të atij Kodi. Pretendimet e kërkuarit për të kundërtën bazohen në një interpretim tepër formal të situatës në fjalë. Kontrolli u lejua nga një gjykatë kombëtare dhe u krye nga policia gjyqësore. Rrjedhimisht, asnjë gjë nuk sugjeron se kërkuari nuk mund të kishte përdorur mjetin juridik, sipas nenit 212 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit se ekzistenca e dyshimeve të thjeshta në lidhje me mundësitë e suksesit të një mjeti të caktuar juridik, i cili nuk është pa dyshim i kotë, nuk është arsye e vlefshme për mosshkrimin e kësaj rruge juridike (shihni *Communaute genevoise d'action syndicale (CGAS)*, cituar më sipër, § 142, me referenca të mëtejshme).

62. Nga kjo rrjedh se kërkuari kishte në dispozicion një mjet juridik efektiv të brendshëm në lidhje me kontrollin e zyrës së tij.

63. Pas ndjekjes së këtij mjeti juridik, kërkuari mund të kishte paraqitur, siç mund të kishte qenë rasti, një ankim të ri kushtetues, i cili është një mjet juridik efektiv që mund të kishte adresuar ankimet e tij sipas nenit 8 të Konventës (shihni paragrafët 21–23 më sipër; krahasoni, gjithashtu, *Zubal'*, § 33, dhe *Haščák*, § 55, të dy të cituar më sipër).

64. Për rrjedhojë ankimi sipas nenit 8 të Konventës aty ku ka të bëjë me kontrollin e zyrës së kërkuarit, duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrimin e mjeteve të brendshme juridike.

65. Ankimi i kërkuarit sipas nenit 13, aty ku ka të bëjë me kontrollin e zyrës së kërkuarit është haptazi i pabazuar, duke pasur parasysh se kërkuari kishte në dispozicion një mjet juridik efektiv në këtë drejtim dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Ankimet për kontrollin e banesës së kërkuarit

66. Gjykata vëren se ankimet dhe argumentet e kërkuarit kanë të bëjnë kryesisht me kontrollin e zyrës së tij (shihni paragrafin 43 më sipër). Sa i përket kontrollit të banesës së tij, kërkuari ka bërë vetëm ankime shumë të përgjithshme, duke pretenduar se kontrolli kishte shkelur të drejtën e tij për respektimin e banesës së tij. Megjithatë, ai nuk ka bërë asnjë ankim specifik dhe as nuk ka paraqitur ndonjë argument në mbështetje të pretendimeve të tij të përgjithshme.

67. Nga kjo rrjedh se ankimet e kërkuarit sipas nenit 8 të Konventës, për aq sa ato kanë të bëjnë me kontrollin e banesës së tij, janë të pabazuara. Për rrjedhojë, kjo pjesë e kërkesës është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

68. Sa i përket ankimit sipas nenit 13, Gjykata vëren se ai është i lidhur pazgjidhshmërisht me atë të shqyrtuar më sipër dhe për këtë arsye duhet të shpallet, gjithashtu, i papranueshëm (shihni *Ljubičić kundër Kroacisë* (vend.), nr. 17338/05, 10 maj 2007).

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 shkurt 2026.

Milan Blaško
KANCELAR

Ioannis Ktistakis
KRYETAR